




Centre for Legal
Empowerment

www.cle.al

MOSMARRËVESHJA NË MARRËDHËNIET E PUNËS DHE NDËRMJETËSIMI



[Read More](#)



ÇFARË DO TË QUHET MOSMARRËVESHJE NË PUNË?

Mosmarrëveshja në punë lidhet kur punëdhënësi dhe punëmarrësi nuk bien dakort ose kanë pretendime në lidhje me:

- Përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kontrata e punës nga të dyja palët
- Zgjidhja e kontratës së punës
- Përfundimi ose pezullimi i Kontratës së Punës
- Marrja e masave disiplinore



ÇFARË ËSHTË NDËRMJETËSIMI?

“Ndërmjetësimi” është procedura e zgjidhjes jashtëgjyqësore të konflikteve që do të lindin gjatë marrëdhënies së punës, ku punëdhënësi dhe punëmarrësi, mbi bazë të vullnetit të lirë, përpiqen për të zgjidhur mosmarrëveshjet me mbështetjen e ndërmjetësit.



KUSH ËSHTË NJË NDËRMJETËS?

“Ndërmjetës” është personi i licencuar dhe i regjistruar në Regjistrin e Ndërmjetësve, i cili zgjidhet vullnetarisht nga punëmarrësi dhe punëdhënësi, të cilit i kërkohet të zhvillojë ndërmjetësimin në mënyrë të paanshme, të përshtatshme dhe të efektshme, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 10385/2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”, i ndryshuar.



KU DUHET TË DREJTOHET PUNËMARRËSI OSE PUNËDHËNËSI PËR TË GJETUR NJË NDËRMJETËS?

Mund të caktohet një ndërmjetës nga lista e ndërmjetësve të regjistruar e cila mund të gjendet:

1

Në faqen e Ministrisë së
Drejtësisë

Në faqen e Dhomës
Kombëtare të Ndërmjetësve
(dhkn.gov.al)

2

3

Në faqet zyrtare të
gjykatave


AVANTAZHET E NDËRMJETËSIMIT

- PUNËDHËNËSI DHE PUNËMARRËSI JANË NË POZITA TË BARABARTA PËR TË GJETUR NJË ZGJIDHJE TË SHPEJTË DHE TË FAVORSHME PËR TË DY PALËT.
- NORMALIZON DHE PËRMIRËSON MARRËDHENIET MIDIS PALËVE DHE KRIJON PREMISA PËR VAZHDIMIN NORMAL TË MARRËDHËNIEVE NË TË ARDHMEN.
- OFRON NJË ZGJIDHJE MË TË SHPEJTË SE PROCEDURAT E TJERA PSH. PROCEDURAT GJYQËSORE.



AVANTAZHET E NDËRMJETËSIMIT

- ËSHTË MË PAK E KUSHTUESHME DHE SHPENZIMET NDAHEN NË MËNYRË TË BARABARTË MIDIS PALËVE
- PROCEDURË TRANSPARENTE KU PUNËMARRËSI DHE PUNËDHËNËSI BASHKËVEPROJNË PËR TË GJETUR NJË ZGJIDHJE TË SHPEJTË DHE TË PËRSHTATSHME.
- I JEP MUNDËSINË PUNËDHËNËSIT DHE PUNËMARRËSIT PËR TË VENDOSUR VETË PËR KUSHTET E ZGJIDHJES SË MOSMARRËVESHJEVE, DUKE SHMANGUR GJYKATËN, AVOKATIN ETJ.



PARIMET MBI TË CILAT ZHVILLOHET PROCEDURA E NDËRMJETËSIMIT


- BARAZIA E PALËVE;
- KONFIDENCIALITETIN E TË
DHËNAVE;
- RESPEKTIMIN E FLEKSIBILITETIT E
TË TRANSPARENCËS SË
PROCEDURAVE;
- RESPEKTIMIN E VULLNETIT
TË PALËVE NË PROCES.



TË DREJTAT E PALËVE NË PROCEDURËN E NDËRMJETËSIMIT

**PUNËDHËNËSI DHE PUNËMARRËSI JANË TË BARABARTË NË PROCEDURËN
E NDËRMJETËSIMIT DHE KANË TË DREJTË:**

- TË ZGJEDHIN NDËRMJETËSIMIN, SI MUNDËSI PËR ZGJIDHJEN E MOSMARRËVESHJEVE TË PËRCAKTUARA NË KËTË LIGJ;
- TË PËRCAKTOJNË KUSHTET, PROCEDURËN, SI DHE AFATET DUKE MBAJTUR PARASYSH PARASHIKIMET LIGJORE;
- TË HEQIN DORË, NË ÇDO KOHË, NGA ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJES ME NDËRMJETËSIM;
- TË NDAJNË NË MËNYRË TË BARABARTË SHPENZIMET DHE TARIFAT E PROCEDURËS SË NDËRMJETËSIMIT.



SI MUND TË ZGJIDHNI NDËRMJETËSIMIN?

APLIKIMI I PROCEDURËS SË NDËRMJETËSIMIT PËR ZGJIDHJEN E MOSMARRËVESHJEVE NË PUNË PËRCAKTOHET ME VULLNET TË PËRBASHKËT TË PUNËDHËNËSIT DHE PUNËMARRËSIT DHE/OSE SINDIKATËS NË RASTIN E KONTRATAVE KOLEKTIVE.

**SHPREHJA E VULLNETIT MUND TË REALIZOHET
NË DY FORMA:**

PUNËDHËNËSI DHE PUNËMARRËSI BIEN DAKORT QË TË PËRFSHIJNË NË KONTRATËN INDIVIDUALE/KOLEKTIVE TË PUNËS NJË DISPOZITË/NEN ME PËRMBAJTJE QË ÇON NË ZGJIDHJE PËRMES NDËRMJETËSIMIT.

PALET NËNSHKRUAJNË NJË ANEKS KONTRATE, KU PARASHIKOJNË RREGULLAT, PROCEDURAT DHE AFATET PËR ZGJIDHJEN E MOSMARRËVESHJEVE ME NDËRMJETËSIM.